



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

10-610/05-130713/25 më 28 AUG 2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit merr këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** zgjerimi i mësimit tërëditor për shtatë (7) shkolla tjera për vitin shkollor 2025-2026.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, në vitin shkollor 2025-2026, do të aplikohet mësimi tërëditor, duke riorganizuar shkollat në modelin e përshkruar si në vijim:
 1. SHFMU "Zenel Hajdini" dhe shkolla "Asim Vokshi" do të shkëmbejnë nxënësit dhe mësimdhënësit, ku shkolla "Zenel Hajdini", do të jetë shkollë e nivelit fillor 1-5, ndërsa shkolla fillore "Asim Vokshi" do të jetë shkollë e nivelit të arsimit të mesëm të ulët dhe do të zhvilloj mësimin për nxënësit e klasëve 6 - 9;
 2. SHFMU "Pjetër Bogdani", do të zhvilloj procesin e mësimit tërëditor në nivelin e arsimit 1-5, ndërsa nxënësit e klasëve 6-9 do të kalojnë në SHFMU "Emin Duraku";
 3. SHFMU "Ali Kelmendi", do të zhvilloj procesin e mësimit tërëditor nga klasa 1-9;
 4. SHFMU "Ditët e Minatorit", do të zhvilloj procesin e mësimit tërëditor nga klasa 1-9;
 5. SHFMU "Ganimete Tërbeshi" do të zhvilloj porcesin e mësimit tërëditor nga klasa 1-5;
 6. SHFMU "Teuta" do të zhvilloj procesin e mësimit tërëditor nga klasa 1-5.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-130694/25 më 28.08.2025

Në bazë të dispozitave të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

- I. Plotësohet ndryshohet Vendimi 14-020/04-0299221/19 i datës 09.12.2019 për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarive afariste.
- II. Sipas pikës I të këtij Vendimi, plotësim ndryshimi nënkupton ndryshimin dhe plotësimin e pikës II, paragrafi 1 të Vendimit, ashtu që në vend të Kryetares znj. Sadije Krasniqi, vendoset znj. Klaudia Mula.
- III. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit me nr. 14-020/04-0299221/19 i datës 09.12.2019.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij.

I D O R Ë Z O H E T:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

